



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.658/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Gjergj Buça” p.f nga procedura e prokurimit “*Procedrë e Hapur*”, me Nr.REF-20531-07-13-2017, me objekt “*Blerje dru zjarri*”, me fond limit 8.296.666 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.08.2017, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes Korcë.

Ankimues:

“Gjergj Buça” p.f
Adresa: Lagjia NR. 14 Ura Dajlanit Durrës.

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes
Dhimitër Denasi Korcë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit REF-20531-07-13-2017, me objekt “Blerje dru zjarri”, me fond limit 8.296.666 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.08.2017, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes Korcë.

II.2. Në datën 07.08.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Pinderi	nuk hapet of	I skualifikuar
- 4S	pa ofertë	I skualifikuar
- Gjergji Bucca	7,742,000	I skualifikuar
- Kopaci	8,095,920	I kualifikuar

II.4. Në datën 14.08.2017 operatori ekonomik “Gjergj Buça” p.f, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Kontrata nr.2 "per shfrytezimin e lendes drusore ne kembe" dhe kontrata nr.1 "Per shfrytezimin e lendes drusore ne kembe" te operatorit me te cilinin eshte lidhur "kontrata e furnizimit"me shoqerine "Koravi"shpk e kane humbur vlefshmërinë ligjore pasi kane tejkaluar afatet kohore te percaktuara ne kontrate.

II.5. Në datën 17.08.2017 operatori ekonomik “Gjergj Buça” p.f ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

[...]

Ne analizuam me kujdes arsyetimin e KVO-së së ak-së dhe gjykojmë se ai është tërësisht i pa drejtë i pabazuar dhe ka për qëllim favorizimin e oe-ve të caktuar. Duke qënë brenda afateve ligjore ne po paraesim ankesën tonë që e mbështesim në argumentat si më poshtë:

Referojmë neni 2 neni 20 të LPP-së[...]

Përsa i përket kontratës nr. 2 “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë” dhe aneks kontratës nr. 1 datë 12.10.2016 “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë” ku në të cilën theksohet afati “Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj më datë 12.10.2016 dhe përfundon në datën 11.06.2017”

Afati i mësipërm datë 11.06.2017 tregon përfundimin e prerjes së lëndës drusore në këmbë (pra thjesht prerjen e lëndës drusore në pyll) dhe jo për shitjen e lëndës drusore. Ky afat nuk përcaktohet me dëshirën e subjektit të cilit i përket kontrata “Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë” por afati:

Bazohet në ligjin nr. 5/2016 “Për shpalljen e monatoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë” Vendimin nr. 438 datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe Rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”

Sqarojmë se: Kontrata e furnizimit me shoqërinë furnizuese “Koravi” mbaron më datën 31.12.2017, pra me të drejtë blerje (furnizim) dru zjarri deri më 31.12.2017, në sasi tepër tepër të mjaftueshme me gjëndjen që ka në magazinë gjëndje kjo nga shrytëzimi i Kontratës nr. 2 “Për shrytëzimin e lëndës drusore në këmbë” dhe aneks kontratës nr. 1 datë 12.06.2016 Për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë” me datë përfundimi 11.06.2017 dhe kjo datë tregon që subjekti shrytëzues “Koravi” nuk ka të drejtë që pas kësaj date të presë lëndën drusore në këmbë (në pyll) por nuk i heq të drejtën dhe nuk i përcaktohet ndonjë afat që këtë lëndë drusore që ka tërhequr nga pylli të mos e tregëtojë: Kjo është e vërtetuar me fatura tatimore shitje “Koravë” dhe blerësi “Gjergj Buca”.

Kërkesa juaj është plotësuar sa më sipër vërtetuam megjithatë ne si operatorë ekonomikë kemi provuar edhe në dokumentacionin tjetër (fatura tatimore shitje dhe deklarata doganore) të dërguar pranë autoritetit tuaj nëpërmjet sistemit elektronik. Si dhe një pjesë e gjëndjes e ilustruar me foto në abjentet tona bashkëngjitur për tju dhënë mundësinë në rast verifikimi së gjëndjes që disponojmë. Pra ak-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 1; 20 të LPP-së[...] si dhe në kundërshtim me VKM-në RRPP-së. Sa më sipër argumentuam Kërkojmë pezullimin e vazhdimit të procedurës Kualifikimin e ofertusit tonë si ofertues që i plotëson të gjitha kushtet

kualifikuese të kërkuara në dst dhe si oferta më e leverdisshme ekonomikisht edhe për vetë autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 23.08.2017, me shkresën nr. 40 prot, operatori ekonomik ankimues “Gjergj Buça” p.f është vënë në dijeni në lidhje refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 28.08.2017 operatori ekonomik ankimues “Gjergj Buça” p.f shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 295 prot., datë 04.09.2017 protokolluar me tonën me numër 1417/2 prot., datë 06.09.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Gjergji Bucca” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Kontrata nr.2 "per shfrytezimin e lendes drusore ne kembe" dhe kontrata nr.1 "Per shfrytezimin e lendes drusore ne kembe" te operatorit me te cilinin eshte lidhur "kontrata e furnizimit"me shoqerine "Koravi" shpk e kane humbur vlefshemërinë ligjore pasi kane tejkaluar afatet kohore te percaktuara ne kontrate”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>
<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi i mallrave</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi Njësi</i>	<i>Çmimi Total</i>	<i>Afati</i>
	<i>Dru zjarri</i>	<i>2.212 mst</i>			<i>31.12.2017</i>

III.1.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2. Ofertuesi duhet te provoje qe ka gjendje apo mund te siguroje brenda periudhes te kerkuar sasine e kerkuar te druve .

Per te provuar sa me siper duhet te paraqese kontrate per shfrytezim te lendes drusore e shoqeruar me leje shfrytezimi ose cdo dokument tjeter zyrtar qe provon se ofertuesi ka gjendje apo mund te siguroje sasine e kerkuar te druve.

III.1.3. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- 1) *Drute duhet te jene te prera dhe te cara per pore vertikale*
- 2) *Te jene te thata*
- 3) *Drute e zjarrit do te jene prej ahu dhe dushku*
- 4) *Drute do te shpërndahen ne institucionet arsimore me metër sterre.*

III.1.4. Në shtojcën 10 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e mallit që kërkohet:

<i>Nr</i>	<i>Pershkrimi i shërbimit</i>	<i>Njesia matjes</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Dru zjarri</i>	<i>mst</i>	<i>2.212</i>

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Gjergji Buca” p.f në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Furnizimi Nr.255 Rep Nr.181/2 Kol datë 17.02.2017 lidhur ndërmjet “Gjergji Buca” person fizik dhe shoqëria “Koravi” shpk me objekt : *Meqënëse shoqëria Koravi shpk është një shoqëri që merret me shfrytëzimin dhe përpunimin e lëndëve drusore e pajisur me Kontratë nr.2 për shfrytëzimin dhe përpunimin e lëndëve drusore në këmbë më datë 13.10.2015 me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Qarku Lezhë dhe me Aneks kontratën nr.1 datë 12.10.2016 “Gjergji Buca” person fizik që merret me tregëtimin e lëndëve drusore për nevojat dhe interesat e tyre palët lidhin sot këtë kontratë furnizim me lëndë drusore (dru zjarri). Kjo kontratë furnizimi lidhet ndërmjet palëve për kryerjen e furnizimit nga ana e shoqërisë Koravi shpk përkundrejt shoqërisë Gjergji Buca person fizik sipas kërkesës. Kohëzgjatja e kontratës fillon më datë 17.02.2017 deri më datë 31.12.2017.*
- Kontratë Nr.2 “Për Shfrytëzimin e Lëndës Drusore në Këmbë” lidhur ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë dhe Subjekti juridik Koravi shpk datë 13.10.2015 me afat një vit datë 13.10.2015-12.10.2016.

- *Leje Shfrytëzimi Nr.1 datë 16.10.2015 lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Lezhë në bazë të kontratës nr.2 datë 13.10.2015 e vlefshme nga data 16.10.2015 deri në datën 31.01.2016*
- *Ankes Kontratë Nr.1 datë 12.10.2016 “Për Shfrytëzimin e Lëndës Drusore në Këmbë”nr.5600 prot datë 14.10.2016 lidhur ndërmjet Bashkia Mirditë dhe subjektit juridik Koravi shpk me objekt shfrytëzimin e lëndës drusore mbeturina (por të përdorshëm) në ngastrat nëngastrat si më poshtë:....*

III.1.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.7. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.8. Në nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 5 “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar”:*

a) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

b) *kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

c) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj62.*

5. *“Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.*

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues Komisioni konstaton se Kontrata Nr.2 *“Për Shfrytëzimin e Lëndës Drusore në Këmbë”* lidhur ndërmjet Drejtoria e Shërbimit Pyjor Lezhë dhe Subjekti juridik Koravi shpk datë 13.10.2015 ka për objekt lëndë drusore të llojit lis ndërsa referuar kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi kërkohet dru ahu dhe dushku. Komisioni gjykon se kjo kontratë nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor edhe për dru ahu por vetëm për dru të llojit dushk.

Ndërsa sa i takon Aneks Kontratës Nr.1 datë 12.10.2016 *“Për Shfrytëzimin e Lëndës Drusore në Këmbë”* nr.5600 prot datë 14.10.2016 lidhur ndërmjet Bashkia Mirditë dhe subjektit juridik *“Koravi”* shpk me objekt shfrytëzimin e lëndës drusore mbeturina sikundër del edhe nga objekti nuk dëshmojnë për dru cilësorë zjarri sipas kërkesave të autoritetit kontraktor por mbeturina. Vendimi nr.391 datë 21.06.2006 i Këshillit të Ministrave *“Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave”* i ndryshuar përcakton shprehimisht se *“Në mbeturinat e pyllit do të futet vetëm ai material drusor (i kalbur, gjysmë i kalbur), i cili nuk plotëson parametrat për dru zjarri. Gjithashtu me këtë kontratë nuk plotësohet kërkesa e autoritetit kontraktor edhe për dru ahu pasi lloji i drurit që do të shfrytëzohet për prerje është lis. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ofron garancinë e nevojshme për furnizimin me dru zjarri në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe për realizimin me sukses të kontratës.*

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gjergj Buça” p.f për procedurën e prokurimit “*Procedrë e Hapur*”, me Nr.REF-20531-07-13-2017, me objekt “*Blerje dru zjarri*”, me fond limit 8.296.666 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.08.2017, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1417 Protokoli, Datë 28.08.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha